



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016, Kryetari i Komunës nxjerr,

**VENDIM
PËR NDALIMIN E VENDOSJES SË OBJEKTEVE TË PËRKOHËSHME NË SHESHIN
"ADEM JASHARI" TË QYTETIT TË LIPJANIT**

I. NDALOHET, vendosja e objekteve të përkohëshme të tipit montazh, paisjeve lëvizëse, tavolinave ose të ngjashme nga ana e personave fizik ose juridik në sheshin "Adem Jashari" të qytetit të Lipjanit.

II. Për mosrespektim të ndalesës së cekur në pikën I të këtij vendimi do të ndërmirren masat përkatëse konform legjislacionit në fuqi.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:
Drejtoratit për Shërbime Publike
Drejtoratit për Inspektorat

1Nr. 353-32452
Lipjan, më 29.07.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

